



AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" B U S H I SHPK "

1. Une i nenshkruari Bujar Bushi , lindur me me pasaporte Nr. shtetas i Republikes se Shqiperise dhe banues ne Tirane ne Rrugen "Mine Peza " Pallati 224. deklaroj se me vullnetin tim te lire dhe ne mbeshtetje te Nenit 37 e vijucs te Ligjt Nr.7638 datc 19.11.1992 "Pcr Shoqerite tregtarc" themeloi Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin:

" B U S H I SHPK"

2. Shoqeria eshte person juridik privat shqiptar qe ne te gjithe veprimtarine e vet i nenshtrohet Legjislacionit te Republikes se Shqiperise .
3. Shoqeria do te kete seline e vet ne qytetin e Tiranes ne adresen :
Ruga "Mine Peza" Pallati Nr.224.
4. Objekt i veprimtarise se Shoqerise do te zhvillohet ne fushen eksportit dhe importit te artikujve te konsumit , artikujve industriale ,material ndertimi , makineri , pjesa nderrimi , vegla pune , tregeti me shumice dhe pakice te ketyre artikujve , riparim dhe mirembajtje automjetesh , investime ne objekte tregtare dhe industriale , konsulence teknike , .
5. Shoqeria mund te hape filiale dhe zyra , magazina ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
6. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga kontributet e Ortakut te vetem .
Kapitali themeltar mund te shtohet ne vartesi te veprimtarise se Shoqerise.
7. Ortaku i vetem eshte ne te njejten kohe edhe administrator i Shoqerise "B u s h i SHPK". Ortaku i vetem , qe ka edhe detyren e administratorit i jepen te gjitha kompetencat , te cilat ai i pranon, pcr te kryer te gjitha formalitetet c themelimit te Shoqerise , te parashikuara nga Legjislacioni ne fuqi.Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise nga casti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar, brenda afatit te parashikuar.
8. Kohezgjatja e Shoqerise eshte dhjete vjete , me te drejten e riperteritjes se afatit me miratimin e shkruar te Ortakut te Vetem


9. Viti finanziar mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti.

10. Te gjitha mosmarreveshjet ndermjet Ortakut te vetem dhe te punesarve ne Shoqeri, zgjidhen me mirekuptim .Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen me mirekuptim , Shoqeria ngarkon nje avokat , rekomandimet e te cilit kane vleren e nje mendimi paraprak . Kur ka rezerva ndaj ketyre rekomandimeve personat mund t'i drejtohen Gjykates se rrethit , ku ka qendren Shoqeria ,sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile.

11. Me miratimin e Ortakut te vetem ne Shoqeri mund te bashkohen edhe ortake te tjere , duke derdhur kontributin e tyre ne lek ose ne natyre , sipas marreveshjes . Ne Shoqeri mund te punesohen punetore dhe specialiste te profesionave te ndryshme , duke lidhur me ta kontrata pune , sipas Ligjeve ne fuqi.

12. Te punesarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e veprimtarise se Shoqerise, karakterin konfidential te dokumentacionit, te informatave, njojurive dhe pervojes se fituar ne kuadrin e veprimtarise se Shoqerise , si dhe te marrin masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre.

13. Organ drejtues i Shoqerise eshte Ortaku i vetem , te cilit ligja i njeh te drejtat qe ne Shoquerite e tjera i ka Asambleja e Ortakeve . Vendimet e marra ne kundershtim me permbytjen e kesaj pike mund te anullohen me kerkese te cdo personi te interesuar.

14. Dispozita me te hollesishme per Shoqerine vendosen ne Statutin e saj , i cili eshte pjesa perberese e ketij Akti Themelimi.

Ky akt themelimi dhe statut u he ne pese kopje , u gjet ne rregull dhe u firmos me vullnetin e lire te Ortakut te vetem.Kopjet jane destinuar: Gjykaten e Rrethit Tirane, Noterit, Bankes , Zyres se tatimeve , Ortakut te Vetem.

Ortaku i vetem

B U J A R B U S H I

Tirane me

1996.





STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BUSHI SHPK"

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "BUSHI SHPK", e cila ne kete Statut me poshte do te thirret Shoqeria, eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit te firmosur ne daten 21.05.1996 nga ortaku i vetem Zoti Bujar Bushi ne perputhje Ligjin e Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare", per te zhvilluar aktivitet ekonomik sic parashikohet nga Akti i themelimit, si dhe nga ky Statut.

Dispozita te Pergjithshme **Neni 1**

Shoqeria eshte person juridik i te drejtës shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e Aktit te themelimit dhe ketij Statuti.

Objekti i veprimtarise **Neni 2**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise zhvillohet ne ato fusha qe jane permendur ne Aktin e themelimit:

- Eksport dhe import te artikujve te konsumit , artikujve industriale , materialeve te ndertimit , makinerive , pjeseve te nderrimit , vegla pune .
- Tregeti me shumice e pakice te ketyre mallrave .
- Riparim e mirembajtje automjetesh
- investime ne objekte tregtare e industriale
- konsulencë biznesi e teknike
- Aktivitet ne fushen e sherbimeve .

Selia e Shoqerise **Neni 3**

Shoqeria e ka qendren e saj legale ne Tirane (Shqiperi), ne adresen: Rruga



"Mine Peza" Pallati Nr.224 Shoqeria mund te krijoje, transferoje, apo te suprimeo qendra administrative, seli, filiale, agjenci dhe zyra si ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

Kohezgjatja
Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per dñjete vjet. Ortaku i vetem mund te vendose zgjatjen e ketij afati, ose zgjidhjen e parakoheshme te Shoqerise.

Detyrimet e ortakut te vetem
Neni 5

Ortaku i vetem duhet te kryej depozitimin e kapitalit themeltar, per llogari te Shoqerise ne formim, te nje noter, apo te nje banke.

Transferimi i kuotave
Neni 6

Ortaku i vetem mund te kaloje pjese te kuotave te tij respektive personave te tjere, ne perputhje me rregullat e parashikuara ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Paraqitura kontabile
Neni 7

Operacionet e Shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe paraqiten me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit. Ne mbylli te cdo viti financiar Ortaku i Vetem ose personi i ngarkuar prej tij bejne inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe te hartojne nje raport me shkrim. Ky rapport pasqyron gjendjen e Shoqerise gjate vitit financiar .

Kapitali themeltar
Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1.000 leke.

Operacionet financiare
Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mijete financiare dhe kredi duke iu drejtuar bankave, instituteve te kreditit ose atyre te financimeve lokale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jele percaktuar.

Blerjet e Shoquerise
Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me distinacionin e tyre dhe me objektin e Shoquerise. Shoqeria mund te bleje dhe te administroje mallra te cfardo iloji e natyre dhe mund ti jape mallrat e saj si garanci per te marre kredi nga banka apo institute krediti. Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria gezon te drejten te zoteroje mjetet e saj si cdo shoqeri tjeter ose Organizate tregtare - industriale kombetare shqiptare, ne perputhje me ligjin nr. 7496, date 04.08.1992 dhe ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoquerite Tregtare".

Fondet Rezerve
Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillim, etj. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e ketyre fondeve, perdonimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohet nga Ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te Shoquerise raportohen ne bilanc me vlera te shprehura ne leke shqiptare dhe ne dollare amerikane, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe llogarijjet ekonomike te Shoquerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe te llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoquerite industriale e tregtare ne Shqiperi. Bilancet vjetore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.

Planet financiare
Neni 12

Aktiviteti i Shoquerise realizohet mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin industrial-tregtar. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat te shprehura ne leke shqiptare dhe ne dollare amerikane. Gjendja pasurore dhe llogarija ekonomike do te paraqiten ne leke. Resultatet financiare te aktivitetit te Shoquerise paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare me monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ai i vendosur nga Banka e Shtetit Shqiptar.



Drejtimi i Shoqerise Neni 13

Organ drejtues i Shoqerise eshte Ortaku i vetem

Ortaku i vetem Neni 14

Ortaku i vetem ne pershtatje me nenin 61 te ligjit nr. 7638 "Per Shoqerite Tregtare" ne drejtimin e Shoqerise te themeluar prej tij ka po ato te drejta qe ky ligj i njeh Asamblese se Ortakeve. Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e tij.

Administratori Neni 15

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar administrohet nga nje ose disa persona fizike. Administratori emrohet me vendim te ortakut te vetem. Ne rast se ortaku i vetem nuk vendos ndryshe, administratori emrohet per tere periudhen e ekzistences se Shoqerise.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredheniet me te trete , ne emer te shoqerise , ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe Ligja ia jep shprehimisht Ortakut te vetem .

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve , per shkelje te ligjeve , te Statutit apo per shkelje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Administratori shkarkohet me vendin te ortakut te vetem . Cdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlesthme . Ne rast se shkarkimi eshte bere pa aresye te drejta , ai le shkak per demshperblim financiar.

Raporti i administrimit , inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga administratori.

Ortaku i vetem miraton llogarite . Ortaku i vetem mund te delegoje kompetencat e veta . Vendimet e tij te marra ne vend te asamblese , evidencohen ne nje regjister.

Raportet e Punes Neni 16

Raportet e punes ndermjet Shoqerise , filaleve dhe agjencive te saj dhe te punonjesve irregullohen mbi bazen e nje kontrate pune . Per sa nuk parashikohen ne kontraten e punes , aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi per kete



**Perfundimi i aktivitetit
Neni 17**

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar prishet ::

- a-. me kalimin e afatit te fiksuar per kohezgjatjen e saj;
- b-. per pamundesine e realizimit te objektit te Shoqerise;
- c-. me vendim te ortakut te vetem.

**Likujdimi
Neni 18**

Likuidimi i Shoqerise do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne ate kohe. Ortaku i vetem do te percaktoje modalitet e likujdimit dhe do te emroje nje ose shume likuidatore, duke percaktuar fuqite e tyre dhe shperblimin. Ne rast te zgjidhjes se Shoqerise mbetja eventuale, sapo te paguhen te gjitha pasivitetet, i takon ortakut te vetem.

**Mosmarreveshjet dhe ligjet qe aplikohen
Neni 19**

Lidhur me mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin gjate aktivitetit te Shoqerise, kane fuqi ligji nr. 7764, date 02.11.1993 "Mbi investimet e huaja", si dhe ligji nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare", si dhe normat e perfshira ne Aktin e Themelimit te Shoqerise dhe ne Statutin ne fjale. Per te gjitha konfliktet qe rrjedhim nga marredheniet e krijuara nga ky Statut eshte kompetente Gjykata e shkalles se pare ne vendit ku Shoqeria ka seline.

Neni 20

Per ceshtje qe nuk kane gjetur pasqyrim ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut, do te zgjidhen duke iu referuar ligjit te vecante qe ka qene ne fuqi ne kohen kur ato kane ndodhur. Ne rast se dispozita te vecanta te ketij Statuti behen te pavlefishme ose kane boshlleqe ,kjo nuk prek vlefshmerine e dispozitave qe mbeten. Ne keto raste eshte e vlefshme ajo dispozite qe eshte ne frymen e qellimit te kesaj kontrate .

Ortaku i Vetem

Bujar BUSHI